

I nderuar prind ose kujdestar:

Shëndeti i fëmijës suaj është i rëndësishëm për ne. Në New York City Public Schools (Shkollat Publike të Qytetit të Nju-Jorkut), orët e edukimit shëndetësor në arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë përfshijnë mësimet mbi parandalimin e dhunës dhe lëndimeve; shëndetin social, emocional dhe mendor; ushqyerjen dhe aktivitetin fizik; parandalimin e përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogave të tjera; si dhe shëndetin seksual, duke përfshirë HIV-in. Tani më shumë se kurrë, nxënësit duhet të zbatojnë aftësitë jetësore që mësojnë në edukimin shëndetësor për të parandaluar sëmundjet, për të pasur akses në informacion dhe shërbime të vlefshme shëndetësore dhe për t'u kujdesur për shëndetin e tyre social, emocional dhe mendor.

New York State Department of Education (Departamenti i Arsimit i Shtetit të Nju-Jorkut) kërkon një kurs gjithëpërfshirës, njësemestral, të edukimit shëndetësor si në arsimin e mesëm të ulët, ashtu edhe në atë të lartë. Në këtë lëndë, nxënësit mësojnë si të jetojnë një jetë të shëndetshme dhe të shmangin sjelljet e rrezikshme. Orët e edukimit shëndetësor për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë përfshijnë mësimet rreth shëndetit seksual, të përshtatura për moshën e fëmijës suaj. Këtu përfshihen mësimet vjetore të detyrueshme nga shteti për edukimin mbi HIV-in.

Mësimet rreth shëndetit seksual u ofrojnë nxënësve informacion të saktë mjekësor dhe aftësi komunikimi për t'i ndihmuar të marrin vendime që i mbajnë të shëndetshëm dhe të sigurt. Qëllimi ynë i përbashkët është të shtyjme sa më shumë fillimin e aktivitetit seksual të rinjtë në moshë shkollë.

Ne jemi të vetëdijshëm se nxënësit tanë dhe familjet e tyre kanë besime, kultura dhe zakone të ndryshme. Këto vlera janë udhërrëfyes themelorë dhe thelbësorë për jetën e fëmijës suaj. Në cilësinë e prindit/kujdestarit, ju keni të drejtën ta përjashtoni fëmijën tuaj nga disa mësimet që kanë të bëjnë me kontrollin e lindjeve dhe/ose metodat e parandalimit të HIV-it dhe infeksioneve seksuale të transmetueshme (STI). Megjithatë, ju nuk mund ta përjashtoni fëmijën nga mësimet për abstinencën apo nga temat e tjera të edukimit seksual. Nëse keni pyetje për mësimet nga të cilat mund ta përjashtoni fëmijën, ju lutemi të kontaktoni me drejtorin, koordinatorin e prindërve ose mësuesin e edukimit shëndetësor në shkollën e fëmijës suaj.

Nëse dëshironi që fëmija juaj të përjashtohet nga mësimet për kontrollin e lindjeve dhe/ose parandalimin e HIV/STI-ve, dërgojini një letër drejtorit të shkollës së fëmijës. Në letër duhet të theksohet se: Fëmija nuk duhet të marrë pjesë në mësimet që trajtojnë kontrollin e lindjeve dhe/ose metodat e parandalimit të HIV-it/STI-ve; dhe Do ta mësoni në shtëpi fëmijën rreth parandalimit të HIV/AIDS.

Ashtu si në çdo fushë tjetër, prindërit dhe kujdestarët janë mësuesit e parë dhe më me ndikim në jetën e një fëmije. Prindërit, kujdestarët dhe shkollat ndajnë një qëllim të përbashkët: ne duam që nxënësit e të gjitha moshave të jenë të shëndetshëm në të gjitha aspektet e jetës së tyre. Ju nxisim të bisedoni me fëmijën tuaj për atë që mëson në klasë dhe të ndani me të vlerat tuaja për mënyrën e një jete të shëndetshme. Nëse dëshironi të mësoni më shumë rreth orëve të edukimit shëndetësor të fëmijës, flisni me drejtorin dhe mësuesin e tij.

Gjithë të mirat,



Melissa Aviles-Ramos
Kancelare (Chancellor)